



Data: 18.05.2018

Ref.: 494/18 D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më 22 Shtator 2017, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa nr.669/17 e datës 14.09.2017 e Kolegjit “Universum”. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr. 800/16 i datës 05.09.2016.

Arsyetimi

Kolegji “Universum” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim nr.680/18 e datës 20.09.2017 të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr. 800/16 i datës 05.09.2016 në lidhje me vendosjen e numrit të kufizuar prej 60 studentëve për pranim në programin e studimit BA Gjuhë Angleze.

Pas shqyrtimit të kërkesës KSHC mori vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të Kolegjit “Universum”. KSHC konsideroi se gjendja faktike e Kolegjit “Universum” në momentin e vlerësimit është konsideruar dhe trajtuar me saktësi nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit. Ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë qenë plotësisht të vetëdijshëm që gjatë vlerësimit të tyre duhet të bëjnë vlerësimin e programit të studimit në raport me kapacitetet që institucioni i ofron. Dhe në këtë drejtim, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë konsideruar se programi i studimit BA Gjuhë Angleze mund të akreditohet vetëm nëse në atë program të studimit pranohen 60 studentë dhe ky numër është në përputhje me standardet e cilësisë të parapara në Udhëzimin Administrativ për Akreditim, i cili ka qenë në fuqi në momentin e marrjes së vendimit.

Duke pasur parasysh arsyet e cekura më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendim.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 131, të Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr. 05/L-031. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimin të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Universum"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

